



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 136, datë 12.07.2019

PËR
PRAKTIKËN PROFESIONALE TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË TË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR PERIUdhËN
KORRIK 2019- QERSHOR 2020

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në mbështetje të neneve 14 dhe 33 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit të Këshillit nr. 45, datë 19.03.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës”, si dhe në kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës,

VENDOSI:

1. Të caktojë, për periudhën 1 korrik 2019 - 30 qershor 2020, magistratët prokurorë udhëheqës, për kandidatët për magistratë, profili prokuror, për vitin akademik 2019-2020, sipas listës bashkëngjitur.
2. Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe magistratët prokurorë udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.



KRYETAR

GENT IBRAHIMI



**LISTA E MAGJISTRATËVE PROKURORË UDHËHEQËS
PËR PERIUdhËn 2019 - 2020**

Nr.	Emër Mbiemër Vitet i III-të	Katër mujori i I Korrik-Tetor 2019	Katër mujori i II Nëntor 2019 -Shkurt 2020	Katër mujori i III Mars 2020-Qershor 2020
	Kandidati Magjistrat	Prokuror	Prokuror	Prokuror
1.	Enkeleda Hoxha	Ida Ahmetlli Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	Olsi Dado Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	Armand Gurakuqi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
2.	Gazmend Frengu	Sokol Malaj Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	Mirela Zavalani Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	Daniela Sulaj Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë